

VENDIM
Nr. 255, datë 6.4.2016

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 217, DATË 23.3.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARKIVAVE, PËR DEGËN E ARKIVIT SHTETËROR VENDOR, NË VLORË, TË DISA OBJEKTEVE DHE TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI FUNKSIONAL, BRENDA TERRITORIT TË PRONËS

NR. 906, ME EMËRTIM “REPARTI USHTARAK NR. 7008, FAKULTETI TEORIK”, ME VENDNDODHJE NË VLORË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR, E PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 660, DATË 4.8.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 121, pika 1, e 124, pika 1, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 217, datë 23.3.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, për Degën e Arkivit Shtetëror Vendor, në Vlorë, të disa objekteve dhe të një sipërfaqeje trualli funksional, brenda territorit të pronës nr. 906, me emërtim “Reparti ushtarak nr. 7008, Fakulteti Teorik”, me vendndodhje në Vlorë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, e për një shtesë në vendimin nr. 660, datë 4.8.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar”.

2. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, drejtori i Përgjithshëm i Arkivave, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi